



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 27, datë 9.2.2021

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË URDHRIN NR.169,  
DATË 5.10.2017, TË KRYEMINISTRIT, "PËR MIRATIMIN  
E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË MINISTRISË  
SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të nenit 7, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", dhe të nenit 21, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.169, datë 5.10.2017, të Kryeministrit, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Skema 1, që përmendet në pikën 1, të zëvendësohet me skemën me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Në skemën 2, që përmendet në pikën 2, të bëhen këto ndryshime:
  - a) Nënndarja 4.2.4 ndryshohet, me këtë përmbajtje:

**"4.2.4. Sektori i programeve të zhvillimit të ndihmës ekonomike**

Përgjegjës sektori	III-a	(4)
Specialist	III-b	1; 3."

- b) Pas nënndarjes 4.2.4 shtohet nënndarja 4.2.5, me këtë përmbajtje:

<b>"4.2.5. Sektori i programeve të zhvillimit të aftësisë së kufizuar</b>		(3)
Përgjegjës sektori	III-a	1;

Specialist

III-b

2.”.

c) Numri i punonjësve të ndarjes 4.2, “Drejtoria e Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, bëhet 17 veta dhe numri i punonjësve të ndarjes 4, “Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, bëhet 44 veta.

ç) Ndarja 7.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

**“7.1. Drejtoria e Auditimit të Brendshëm**

**(5)**

Drejtor

II-b

1;

Specialist

III-b

4.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**



NR.PROT.718/1  
DATË 8/2.2021

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE  
MBROJTJES SOCIALE  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE  
EKONOMISË  
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS  
PUBLIKE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGAÇI**

